

VENDIM
Nr. 186, datë 26.2.2020

**PËR CAKTIMIN E NJËSIVE ZBATUESE PËR RINDËRTIMIN E BANESAVE
INDIVIDUALE, DHE NDËRTIMIN E RIKONSTRUKSIONIN E
INFRASTRUKTURËS PUBLIKE**

(ndryshuar me VKM nr.338, datë 23.4.2020¹)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “iii”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese, për rindërtimin sipas projekteve model, të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale jashtë zonave të reja të shpallura në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Rrogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak, Vorë.

2. Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese, për rindërtimin sipas projekteve model, të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale jashtë zonave të reja të shpallura, në Bashkinë Tiranë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

¹ Ndryshuar titulli dhe pika 1 e 2.